

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**VENDIM**

**Nr. \_\_/2024**

**PËR ZGJEDHJEN E ANËTARIT TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË  
NGA PËRFAQËSUESIT E SHOQËRISË CIVILE SIPAS LIGJIT NR. 115/2016 “PËR  
ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 149, pika 8, të Kushtetutës, nenit 35, pika 16, të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

I. Të konsiderojë të zgjedhur kandidatin e listës së tretë për anëtar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga përfaqësuesit e shoqërisë civile, që ka rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

1. Erion Fejzulla

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R E**

**Elisa SPIROPALI**

Miratuar në datën \_\_. 10. 2024